



Kisha katolike kundër gjakmarrjes me dekret çkishërimi

B. Delijaj / f.10



Gjakmarrja shkatërron familjen Sheqeri

Zef Nika f.5



Studenti i dhjetorit '90 i kërcënuer

Fatime Kulli f.10



Familja Murej dhe hakmarrja msjetare

Redaksia f.5

EDITORIAL

Konflikti me vetveten dhe kërkimi i identitetit europian i shqiptarëve



nga Gjon Keka

Kultura shpirtërore, politike e çdo kombi apo populli sidomos me traditë dhe me moshë të pjekurisë rezultojnë me përgjegjësi të thellë, kulturore, politike, sociale, ekonomike etj. Të gjithë e dimë se çdo komb apo popull ka edhe kulturën e tij dhe burimin e të mirave dhe virtuteve nga të cilat ushqehen ata, por ama të mirave. Ndërsa askush nuk është më xheloz se sa popujt e siudhësës ballkanike, ata vazhdimisht kanë jetuar në hasmëri me njëri-tjetrin jo se këtë e kanë trashëguar por se ka ardhur si aksidenti i piktakimeve historike por jo çdo herë të njejtat ... / f.12



George Washington pati nënë Marije Balën, me prejardhje nga Rrafshi i Dukagjinit, saktësisht nga rrethinat e Pejës nga D.Cacaj, faqe 2

EDITORIAL

Vara-vingat e PDK-së së Ndokës



nga Blerti Delija

Nese ka nje force politike ne Shqiperi qe mund te konsiderohet gjenetikisht e djathte, eshte ajo me fryme apo vokacion demokristian. Idealet, zanafilla dhe historia e veretetojne mese miri pa patur nevojte ti mbushim mendjen ndokujt qe permes elementeve social te doktrines kristiane (qe bazohet Kristian Demokracia si rryme politike) mundohet, eshte munduar apo do te mundohet te justifikojte shmangien politikisht majtas (apo qendres se majte) te PDK-se. Ndalem tek kjo force politike duke patur parasysh se eshte me e konsoliduara e te gjitha simotrave te tjera me mbiemer demokristian.

Eshte e kote te perserisim qe ne Shqiperi, partite e vogla (por edhe te medhate ne shume raste) jane instrumenta ne duart ... / faqe 3

“Të Pastrehët me Status”, një mashtrim dhe vjedhje kolosale Shtet + “Të pastrehë” në dëm të pronarëve qytetarë!

Nga Agron Luka

Historia e “Ç’pronësimit dhe Strehimit” të këtyre “Të Pa Strehëve”, për afro 5 dekada në kohën e Parti-Shtetit tashmë dihet dhe kjo analizë është jashtë objektivit këtu.

Rreth 21 vjet mbas vendosjes së njëfarë demokracie në Republikën e Shqipërisë është një megaskandal të dëgjosh udhëheqësit e dy partive dhe të partitëqave, duke zhvilluar debate me hipokrizitë dhe mashtrimet e tyre rreth problemit të rregullimit të “Pastrehëve me Status” dhe çështjes së rikthimit fizik të banesave, të ashtuquajturve si “ish pronarëve” qytetarë. Më konkretisht është fjala për Aktin Normativ të Këshillit të Ministrave, për detyrimin e të “Pa Stehëve me Status” për të marrë kredi me zero interes ... / faqe 4



Nëpër magjitë e Shkodrës nga Sokol Pepushaj, faqe 6

Mes simpoziumit shkencor shkencor “Kelmëndi në Shekuj” e logut tradicional Mis Bjeshka 2012

Nga Ndue Bacaj

Logu i Bjeshkeve 2012 në treven historike të Kelmendit ketë verë kishte një të veçant të madhe. Organizohet në “100 vjetorin e shpalljes së pavarësisë”, pavarësi për të cilën kelmendasit kishin derdhur lumenjë gjaku e dete mundimesh e sakrificash. Kelmendi në keto lufta e perpjekje shumëshekullore kishte zgjuar interesin e vetë Europes së kohës, e cila jo vetem e vleresonte, por shpesh kishte pasur aleanca e bashkëpunime në kuvende e beteja luftarake kundër osmanëve dhe pushtuesve të tjerë. Pikrisht për të përjetësuar këtë histori të lavdishme shqiptare, kryetari i komunes Kelmend Ing.Gjeto Dukaj ishte bërë promotori ... / faqe 9

George Washington pati nënë Marije Balën, me prejardhje nga Rrafshi i Dukagjinit, saktësisht nga rrethinat e Pejës

DËSHMI QË PARATHONË SE LENINI ISHTE ÇEÇEN DHE FIDEL KASTRO BRITANIK. SIÇ ËSHTË PËR FRANCEZËT SURPRIZË SE DE GOLI KISHTE ORIGJINË ARABE, PËR SHQIPTARËT ËSHTË E RËNDËSISHME TË DIHET KJO.

Për të përzënë çdo dyshim të mundshëm e pasaktësi paradoksale, vjen kumti sipas të cilit Instituti i Biokimisë dhe Gjenetikës në Bazel të Zvicrës, ka kryer ndërkohë një hulumtim të gjenezës së disa prijsave botërorë. Në këtë studim të imët deri në detaje, në krye të listës ishte pamëdyshje dhe Gjergj Vashington-i. Kumti është kokëfortë kur thotë se babi i kombit amerikan është i biri i Agustinit dhe i Marijes.

Nga **Dashamir Cacaj**

Në vitin 1706, një anije e nisur nga bregdeti kroat, pas një lundrimi të mundimshëm mbërrin në brigjet lindore të Amerikës Nordike. Mjeti lundruar e përshkoi tejmbanëshullin gjigant britanik për të mos e hedhur spirancën në ato brigje, por për të vazhduar rrugëtimin përkrah burimi i dritës.

Në bordin e anijes është dhe një çift të rinjsh nga Rrafshi i Dukagjinit. Janë burrë e grua. Po e lënë vendin e të parëve nga orteku i hallevë që i pati vënë në shënjestër edhe ata të dy. Fati është me ta. Mbërrijnë në Virgjina, e veshin kombinoshë për të ndërtuar një të ardhme. Medet që emrat e dy të rinjve nuk na i zbardh asesi, Albert Myko dhe as Virgjina Carmichael. Të dy na e fshijnë pluhurin e harresës me ndihmën e një tupani që është lajmës për një triumf. Anipse emrat e dy banorëve të Rrafshit të Dukagjinit nuk kanë mbriritur ende në gjerdanin e kronikave tona, ne ju jemi mirënjohës për jetë gjuhëtarit e shkrimtares.

Bashkëshortët e rrafshit kanë në xhepin e setrës ende kartelën e mërgimit kur u lind fëmija rishtar. Është vajzë e porsalindura. E marrin në krahë dhe e çojnë në kishën e rrethines. E pagëzojnë me emrin e bukur Marije. Emri është biblik. Edhe mbiemri këtë shije ka kur e përtyp. Bala! Një mbiemër fisi që ka harruar të plakët.

Vitet marrin rrokopujën. Moti 1708 është viti i lindjes së Marijes, e ky sa vjen e largohet. Marije Bala vishet nuse. Po kush është dhëndri pale?! Është bash babai i babait të kombit amerikan, sa kohë i referohemi cilësimit in mortales të tij. Pra, dora vetë ati biologjik i Gjergj Vashingtonit. Dëshmitë na e shuajnë kureshtjen sa kohë na bëjnë me dije se nënë e bir patën mesvedi dashuri e nderim, ndiesi këto të ndërsjellta e të pakufishme. Ekziston në memuarët e Shtëpisë së Bardhë një prokurë e lënë nga presidenti historik i Amerikës së djeshme e asaj të sotshme. Sipas saj, në çdo rrethanë e me çdo mjet, të mbrohet e të sajdiset, vendi i shqipeve buzë Adritaikut, nga kombi amerikan e udhëheqësit e tij.

Për të përzënë çdo dyshim të mundshëm e pasaktësi paradoksale, vjen kumti sipas të cilit **Instituti i Biokimisë dhe Gjenetikës në Bazel të Zvicrës**, ka kryer ndërkohë një hulumtim të gjenezës së disa prijsave botërorë. Në këtë studim të imët deri në detaje, në krye të listës ishte pamëdyshje dhe Gjergj Vashington-i. Kumti është kokëfortë kur thotë se babi i kombit amerikan është i biri i Agustinit dhe i Marijes.

shkërmoqet. Aforizma “u tha, u bë” ia krijsi gazet. Shqipëria ime nis e hedh rrënjë të shëndetshme më 1913.

Jo shumë dekada më vonë, është presidenti Nikson që ia hedh një sy amanetit historik të GjergjUashingtonit. Është viti 1970 kur Nikson i dhuron Titos jo pak, por një qese me 5 miliardë dollarë amerikanë. Një kusht të vetëm pati kjo mbështetje financiare që ringjalli ekonominë e principatës gjigante të sllavëve të jugut. E ky

likë të Shtetit të Kosovës, i has sharra në gozhdë. Dihet kush e “sharroj” premtimin e Titos përpara presidentit amerikan të radhës, Karter. Shkurt Millosheviç “i fut stërkëmbcën” njeriut që i lëshoi fronin e ndihmat ndërpritën. I fundit që e ka parë me miklim porosinë e Gjergj Vashingtonit, është presidenti Klinton. Kjo letër më yshti ta orientoja “NATO-n” për t’ja hequr prangat kombit të Rugovës, mësohet të ketë thënë Klinton.

Kumti që po përcjellim është në shterzim të maturimit të vet. Lyp një kohë, nuk dihet saditëshe. Ngjizja ka startuar bindshëm. Karl Eduard ka hedhur në treg librin “Shtëpia Klinton”. Karli është gazetar, reporter dhe autor i shumë librave dokumentarë në evokim të jetës e të veprimtarive të presidentëve të Shtëpisë së Bardhë dhe të historive të Vendit të Madh. Karli është dhe fitues i çmimit “Pulitzer” në katër edicione të tij. Në dobi të ngjizjes së kumtit që përcjellim është dhe kronika me titull “Marije Bala Vashington”, e vitit 1850 e shkrimtares Virgjina Carmichael. Dëshmi të besueshme siglon linguisti i Universitetit Berkli të Kalifornisë, Albert Myko. Nuk po e bëjmë më të gjatë vistrën e dëshmimeve. Falë Zotit ato nuk shterrin.

Për sa e cekëm në rreshtat e këtij shkrimi, Marije Bala nga Rrafshi i Dukagjinit, vis shqiptar e shqipfolës qyshkur u shfaq arbëri i fillimit, meriton njohje, publicitet, respekt, admirim e nderim pa limit. Edhe një monument e lyp kjo amazonë e mesjetës shqiptare. Në krah e përbri të Roza Fatit, Vojsava Kastriotit, Terezë Bojaxhiut, e të më falë ndonjë tjetër emër i përvetshëm gruaje që nuk e gjen emrin e vet në këtë kronikë që është ngarendje, me gjasë si e vrapit të atkinës kur bashtina është me bar e me gjethe. Koha e ka “tagrin” mos me pritë...



Porosia e lënë nga Gjergj Uashingtoni, në kohë të ndryshme është bërë e gjallë e ka shërbyer si “varkë shpëtimi” për bashkëkombasit e mij. Në krye të herës, mbi paragrafin imëcak të letërporosisë, bie vështrimi i mprehtë i Presidentit Uillson. Ishte ai vakt kur arka e mortit priste mënjane kurmin gjithë dregëza të vendit tim. Presidenti Uillson nuk ngurroi të shprehet në Lidhjen e Kombeve. Të mbetet në këmbë ky komb. Nuk është e drejtë të

kusht ishte i rrokshëm. Të njihet autonomia e Kosovës! Pikë! Tito ofron kushtetutën e vitit 1974, ngasja e të cilës është krijimi i Universitetit Shqiptar të Prishtinës. Dora e ngrohtë e një kombi të madh i zgjatet shtetit që udhëheq Tito është edhe një kreditim i tipit big për dekadën e viteve 1980 e 1990. Tito premtonte statusin e republikës për Kosovën. Aty për aty “u tha, u bë”. Por Tito largohet nga kjo botë e vendimit për dhënien e statusit repub-

hje, publicitet, respekt, admirim e nderim pa limit. Edhe një monument e lyp kjo amazonë e mesjetës shqiptare. Në krah e përbri të Roza Fatit, Vojsava Kastriotit, Terezë Bojaxhiut, e të më falë ndonjë tjetër emër i përvetshëm gruaje që nuk e gjen emrin e vet në këtë kronikë që është ngarendje, me gjasë si e vrapit të atkinës kur bashtina është me bar e me gjethe. Koha e ka “tagrin” mos me pritë...

Vara-vingot e PDK-se se Ndokes

Nga Blerti Delija

Nese ka nje force politike ne Shqiperi qe mund te konsiderohet gjenetiksht e djathte, eshte ajo me fryme apo vokacion demokristian. Idealet, zanafilla dhe historia e veretetojne mese miri pa patur nevojte ti mbushim mendjen ndokujt qe permes elementeve social te doktrines kristiane (qe bazohet Kristian Demokracia si rryme politike) mundohet, eshte munduar apo do te mundohet te justifikojte shmangien politikisht majtas (apo qendres se majte) te PDK-se. Ndalem tek kjo force politike duke patur parasysh se eshte me e konsoliduara e te gjitha simotrave te tjera me mbiemer demokristian.

Eshte e kote te perserisim qe ne Shqiperi, partite e vogla (por edhe te medhate ne shume raste) jane instrumente ne duart e kryetareve per te realizuar qelimet individuale apo te klaneve rrotull. Natyrisht, si pjese e ketij konfigurimi, nuk i shmanget as Partia Demokristiane. Sidomos ajo e 7-8 viteve te fundit.

Kapercimi politik i Nard Ndokes nga PDR-ja e Pollos tek PDK-ja e Lesit, ishte nje levizje me interesa te ngushta apo llogaritje elektorale me shume individuale se ne sherbim te demokristianeve. Gjithsesi koha tregoi se me fuqine e kartonave ne Kuvend-fale kapercimeve politike te disa individeve (edhe ata nisur nga interesa personale) sollen nje pozicionim normal te PDK-se si pjese e mazhorances se djathte te drejtuar nga PD-ja dhe kryeministri Berisha. Ministria e Shendetesise dhe derivate e saj ne nivel ronal dhe menaxhimi nga "demokristianet" jane nje kapitull, i cili meriton analize ne hollesishme se si nuk duhet te leshohet pushtet ne emer "te idealeve qe kane vene themelet e Europes", sic kane permendur shpesh ne kohe te ndryshem lidere te PDK-se ne vite. Askush nuk mund ta thote se ky menaxhim, edhe pse i shkurter ne kohe, ishte sukseshem apo arriti te dale nga linjat e deriatehershme duke dhene nje model qe ia vlen te implementohet serish. Megjithate, me te gjitha gabimet dhe fajet, me gjithe perjashtimin e demokristianeve dhe me grada shkencore nga bashkemenaxhimi i ketij sektori apo sektoreve te tjere qe iu besuan PDK-se asokohe, bashkepunimi i PDK-se me PD-ne e aleatet e djathte te saj ne qeverisje, ishte brenda normale. Eshte e qarte se kjo kohe qeveritare per PDK-ne nuk dha rezultate per forcimin e kesaj force politike. Shenjat jane pare qe ne ate kohe, u pane ne zgjedhjet e vitit 2009 dhe 2011. Duke filluar nga Shkodra (bastion i PDK-se sipas lideve te saj ne vite) dhe deri ne Kospol, kjo force politike nuk ka struktura, rrjedhimisht nuk funksionon, eshte inekzistente. Sot ne Shkoder, askush nuk mund te thote me siguri cili eshte kryetari i PDK-se vendore, edhe pse kujtohet me buje se nje ish-zyrtar i larte vendor i qeverisjes 8- vjecare te PS-se, u vendos ne krye te saj ne prag te zgjedhjeve te 2011 dhe u largua pa shume zhurme. Madje, edhe shume gazetar ne kane infor-

macion se cili eshte kryetari apo lideri i PDK-se ne Shkoder. Sa per publicitetin mediatik- i domosdoshem per nje force politike, askush nuk e kujton qe te kete pare nje lider vendor apo edhe vete kryetarin Ndoka ne mediat lokale te Shkodres. Te pakten prej shume e shume muajsh, per te mos thene vit.

Pas zgjedhjeve te vitit 2009, PDK-ja vendosi te kapercije ylberin, duke u bere ndoshta aleati me i afert dhe famemire i PS-se. Aleancat politike te kesaj natyre jane shume te rradha, jo fitimpruresse per subjektet e vogla dhe kane ne sfond interesa personale te kryetareve. Po cilat ishin keto interesa? PS-se dhe Rames i leverdiste te tregonte ne publik por edhe perballe Europes se ka ne krah partine me te fuqishme demokristiane ne Shqiperi. Kjo eshte ceshtje imazhi, por shume e rendesishme ne politike. Nga ana tjeter, ne thesin e madh te votave qe i duheshin PS-se dhe opozites se majte, perroi demokristian do te shtonte disa mijera me shume. Ceshnja apo pyetja qe shtohet eshte: Keto vota ne emer te kujt i kerkuan apo ne favor te kujt shkuan? Perralla e hapjes se kutive te votimit te 2009-es u pa qarte se ne cfare derexheje perfundoi dhe cilat ishin rezultatet. Kauza u shit "per 5 aspra" politike ne nje nga restaurantet e Krokodileve ne Europe. Votat demokristiane sollen ne krye te shume komunave, te pakten ne Qarkun e Shkodres, shume individe qe nuk i lidhte asgje me PDK-ne pervec lidhjeve apo miqesive me kryetarin. Ne disa raste, perfaqesues te subjekteve te tjera politike kandiduan nen siglen PDK dhe sot e kesaj dite, e kane te veshitre te deshifrojne germat nistore per te arritur tek emri i plote Partia Demokristiane. Ne raste te tjera, votat e bashkuara te PDK-se me te jamte opozitare, sollen ne krye te komunave, bashkive apo derguan ne parlament individe me te kaluar dhe te tashme te dyshimte. Votat u kerkuan ne emer te idealeve Kristian Demokrate, ndersa rriten politikisht individe qe nuk kane asnje lidhje me keto vlera shblime politike.

Pavaresisht se nuk eshte publike, ka patur edhe nje marreveshje gjentellmenses (po e quajme keshtu) ne mes Ndokes dhe Rames (PS). Ne zgjedhjet e prishme parlamentare (2013), Rama garantoj 3 mandate deputetesh per PDK-ne. Madje, jane pefolur edhe emra konkrete si Ndoka apo Zogaj si kandidat-epetete te ardhshem. Me keto skema dhe perlogaritje, incesti politik PS-PDK eci deri ne vjeshten e kaluar (2011). Ate kohe Ndoka "ndjeu" se eshte ne krahun e gabuar politik dhe filloi nje "mea culpa" graduale, njekohe-sisht edhe presion i hapur dhe i fshehur ndaj aleatit PS. Ne fakt, Ndoka u hapur ofertat e mazhorances, te cilat per te rikthyer PDK-ne ne kampin natyral te djathte, mund te ofronin poste bashkeqeverisjeje si zv.minister apo prefekt. Duke patur parasysh se kryetaret kerkojne me shume, posti i ministrit te kerkuar nuk iu dha asnjehere PDK-se dhe Ndokes. Eshte e qarte se llogaritje behen nga te dy palet: PD-ja i kishte

numrat e nevojshem per qeverisje me aleatet dhe nuk mund ti dhuronte nje dikaster PDK-se pa asnje mandal deputeti.

Atehere doli ne skeme alternativa tjeter, Top-Partia apo sic u quajt ne pranveren e 2012-es, Fryma e Re Demokratike. Sipas gjasave e deklarimeve, Ndoka dhe PDK-ja e tij, do te tentojne ti afrohen kesaj linje politike, duke qene sipas tyre, ne te djathte te politikës shqiptare. Historia tregon se Poli i Tetre ne politike, shtypet si sanduic me mes dy te medhenjeve PS dhe PD. Megjithate, per nje moment te mendojme se ky pol mund te ngrihet ne kembet dhe te eci. Eshte e qarte se tashme ky pol, do te paraprihet nga perlogaritje matematikore qe derivojne ne shperndarje perfitime mandatesh deputeti. Edhe kete here, si gjithhere, Ndoka do te perlogaris perfitimet individuale dhe te njerezve prane tij dhe asnjehere te PDK-se dhe demokristianeve shqiptare. Me Topin do ta kete me te lehte, pasi ne kohen kur milonin ne PD, nuk kane patur relata te keqija.

Por kjo sipas gjasave, nuk do te jete vara-vingoja e fundit e Ndokes ne prag te zgjedhjeve te vitit 2013.

Me nje eksperience te lakmueshme lundrimi mbi ujien e politikës shqiptare keto 20 vite, Ndoka nuk do te ngutet. Urat e komunikimit nuk i ka nderprere plotesisht as me PD-ne dhe as me PS-ne. Ne nje fare mase, ai eshte ne pritje te zhvillimit te nje tenderi me imazhin demokristian: cili ofron me shume per Ndoken dhe enturazhin e tij aktual! Sa per idealet, ato ne politikën shqiptare kane vdekur thuajse qe ne lindje, fatkeqsisht edhe per Partine Demokristiane. Akrobati i politikës shqiptare Nard Ndoka, akoma nuk e ka vendosur se ku do te derdhe peroin e votave demokristiane, te cilat ai mendon se i ka pas vetes. Problemi i vetem eshte nese ky perrua eshte i gjalle, apo ka shterruar nga vara-vingot e lidershipit. 6 muaj demokristianet jane sivellezet me demokratet, 6 muaj jane sivellezet me socialistet. Strategjia e Ndokes i ngjet shume asaj te ndjekur nga Shqiperia komuniste e Hoxhes. Ai aleat qe i jep me shume politikisht por edhe ekonomikisht, i atashohet dhe nuk e ka aspak problem se luan me ndjenjat e mijera demokristianeve shqiptare anem-bane Shqiperise.

Homoseksualët nuk i pranon kurrësi shoqëria shqiptare

Rastet janë të shumta, kur persona të veçantë kanë zbuluar prirjet e kunderta seksuale, jo vetëm nuk janë pranuar nga shoqëria, por edhe janë therur me thikë në fytyrë, deri në qendër të kryeqytetit, Tiranë. Rasti më makabër ka qënë ai i tranvestitit me emer Kristina që u pre me thike në fytyrë afër hotejt Dajtit dhe megjithëse kish lajmëruar policinë për rrezikun, askush nuk i dha ndihmë. Megjithëse kanë kaluar shumë vite askush nuk ka mbajtur përgjegjësi për këtë ngjarje. Edhe rasti i Klodin Çelës, ish finalist i reality-show Big Brother 3, ndezi protesta mbarëpopullore ne Shqipëri derisa u detyruan ta mbrojnë publikisht ambasada e SHBA, e Anglisë, Danimarkës, Francës dhe shumë të tjera dhe rasti Klodi u shua vetëm pasi shqiptaret nuk e shohin më Klodian Çelën. Duket se është larguar në ndonjë shtet që i respekton lirinë e tij seksuale. Në këto kushte është edhe ky i ri që shihni në këtë foto. Prirjet e tij homoseksuale i zbuluan ca nxënës të shkollës së tij. Quhet Diamant Pepushaj, lindur më 23.05.1995. Është nxënës në shkollën e mesme profesionale Teknologjike në qytetin verior Shkodër. Personi mësojmë se është fyer dhe disa herë kërcënuar se do e vrasin kudo që e identifikojnë si gay. Nuk mund të lëvizë në vende publike dhe shokët e shoqet e fyejnë e nuk e pranojnë as afër. Ajo çka dëshmon për një shoqëri patriarkale në Shqipëri është fakti se edhe familja nuk e pranon Diamantin. Madje gjithë i tij, i quajtur Luigj, u shpreh për gazetën se 'rasti i nipit tim është një turp. Nuk është më nipi im. Zoti ka krijuar burrin e gruan, por jo të bëhet mashkulli femer e femra mashkulli...'

E ngritëm këtë rast për të sensibilizuar sadopak shoqërinë shqiptare të jetë më e butë, jo kaq e egër, pasi bota e qytetëruar respekton të drejtën e seksualitetit të çdo personi. **Redaksia**




Gjakmarrja, ky vrasës që përditë po hapë varre

Grabitjet, ngatërresat, vrasjet, janë mozaiku që përplotëson tablionë e zezë të jetës shqiptare. Vetëm 20 vitet e fundit sipas gazetarit italian Ettore Mo, i cili botoi një shkrim në gazetën prestigjioze Corriere della sera, në Shqipëri janë vrarë rreth 20 000 shqiptarë për shkak të konflikteve nga më banaanet, të cilat kanë kaluar në hakmarrje e ne gjakmarrje. Në Shqipëri në fakt fshiheshmë nga rastet tragjike, duke u perpjekur të mashtrohet Europa, por gjithsesi edhe te dhenat zyrtare jane tepër të zymta. Diku rreth 10 000 të vrarë, pra gjysma e tyre. Megjithatë, shkrimi i Corriere della sera nuk është përgjyeshtruar nga Ministria e Jashtme e shtetit tonë, megjithëse gazeta jonë e pati ribotuar të plotë edhe në gjuhën shqipe. Vetëgjyqësia që buron nga Kanuni mesjetar i Lekë Dukagjinit, po gjen terren shumë favorizues në kushtet aktuale të mungesës së shtetit, të korrupsionit në gjykatat e në prokurori, ku vetë kryeministri Sali Berisha e pranon këtë fenomen, sa kohë që akuzon publikisht ish presidentin Bamir Topi që nga pozicioni i ish Kryetarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë ka marrë deri në 200 000 euro nga prokurorët e gjykatësit edhe për të lëvizur nga qytetet, me punë në Tiranë. Kështu pra krimi çdo ditë rritet e viktimat e pafajshme shtohen. Një ndër viktimat e pafajshme të kësaj kohe të çmendur është edhe Izmir Bardica, një djalë i ri nga qyteti verior Shkodër. Gjatë sezonit të plazhit kishte një supermarktet në plazhin e Velipojës, një plazh që këtë vit kishte vetëm kosovarë rreth 70 000 persona çdo 15 ditësh. Edhe krimet në këtë plazh ishin prezente. Kështu, më datën 25 gusht 2012, rreth orës 23 00, në supermarktetin ushqimor të shtetasit Izmir Bardica, në qendër të plazhit Velipojë, pranë Kompleksit Turistik Fishta, tre persona të maskuar dhe me automatikë në duar, sulmojnë për të grabitur, për tu bërë të pasur siç po ndodh rëndom edhe në Tiranë, ku në mes të ditës është vrarë një grua vetëm për të marrë varësen e floririt në qafë. Po le të mbetemi tek ngjarja në Velipojë. Tre personat kanë qëlluar me armë zjarri në mes të supermarktetit, në mes të plazhit, kanë terrorizuar gjithë njerëzit aty, kanë dhunuar fizikisht të zotët e supermarktetit dhe kanë arritur të grabisin gjithë paratë e xhiros së ditës. Gjatë grabitjes, babai i shtetasit Izmir Bardica, i quajtur Bahri Bardica, në vetmrojti e sipër, pasi grabitesit e kanë qëlluar me grushte e shqelma, ka kapur një karrike dhe ka qëlluar njërin nga grabitësit me maska. Vëndi është gjakosur. Grabitësit kanë marrë paratë me vete, por edhe të plagosurin e kanë hyhur në makinën e tyre dhe janë larguar. Por ngjarja e zezë nuk e ka fundin këtu. Të nesërmen e asaj dite, rreth mesnatës, një person i pamaskuar shkon në supermarktet krejt i qetë dhe i thotë Izmir Bardices se ai dhe familja e tij duhet të mbyllin biznesin dhe të ngujohen, pasi sipas Kanunit të Lek Dukagjinit, është në gjak, pasi babai i tij ka plagosur me karrige shokun e tij që kishte nevojë për ca para. Kështu, Izmir Bardica detyrohet të mbyllë supermarktetin dhe të ngujohet në shtëpi të vet në lagjen Dergut të qytetit të Shkodrës. Edhe aty e gjejmë. Më datën 10 shtator 2012, rreth orës 21 e 30 minuta, makina e shtetasit Izmir Bardica, e parkuar para banesës së tij, shpërthen e digjet nga një sasi tritolit. Për fat kanë munguar viktimat. Por vrasjet me tritol në Shkodër tashmë janë të shpeshta. Kujtojmë vrasjen me minë të telekomanduar të kambistit Mark Gjoni në tetor të vitit të kaluar në qendër të qytetit të Shkodrës, kur në momentin që po parkonte makinën e tij tip "Benz" me targa SH 1465 E, automjeti ka shpërthyer dhe është përfshirë nga flakët brenda pak minutash. Zhurma e shpërthimit ka qënë tepër e fuqishme, sa që është ndër të gjithë qendrën e qytetit. Kambisti ka mbetur i vdekur. Kështu edhe Izmir Bardica ishte afër vdekjes, por fatmirsisht nuk ka ndodhur në makinën e parkuar para banesës. Që nga nata e shpërthimit shtëpia është boshatisur dhe nuk dihet se ku jetojnë, të fshehur, të ngjuar. Fotografina që po botojmë dhe disa nga të dhënat, i morëm nga një kushëri i viktimës pa faj Izmir Bardica, të cilin e siguruaam se do e mbajmë anonim, pasi ka frikë të lakohet emri në shtyp, pasi ka frikë se ata që sulmuar për të vrarë Izmirin do vënë në shënjestër të hakmarrjes edhe atë.

Redaksia

Ne Shqipëri, Kanuni me i forte se ligji!

Situata kriminale ne Shqipëri eshte acaruar ndjeshem gjate vitit 2012. Klima e ashpër politike dhe si vit paraelektorat, kane ndikuar ne shtimin e veprave kriminale. Gjate vitit 2012, sipas statistikave zyrtare ka mesatarisht 2-3 te vdekur ne dite si pasoje e vrasjeve me arme zjarri apo edhe vrasjeve nga aksidentet automobilistike, qe te gjitha te klasifikuara si gjakmarrje apo hakmarrje. Tashme krimi ndodh ne cdo vend, ne rrugte, ne lokale madje edhe ne deren e shtepise. Kjo eshte nje nga arsytet qe shume perfaqesi diplomatike ne Shqiperi kane keshilluar shtetasit e tyre te jene te kundershme ne levizje ne rrugete e qyteteve te ndryshme. Ajo cfare eshte me shqetesuese eshte perفشirja ne episode te ndryshme edhe e individeve te pafajshem. Elsaid Sala, banues ne qytetin e Shkodres ishte i punesuar si kamarier ne nje lokal ne Rus, ne pronesi te Bahri Rragamit. Permes kesaj pune, ai arrinte te siguronte te ardhura sa per te ndihmuar familjen e tij. Fati i keq i Elsaidit solli qe te ishte ne pune tekasa ne lokalin ku sherbente, me date 2 mars 2012, rreth ores 22:00 ndodhi nje shkembim zjarri ndermjet dy personave, ku per pasoje mbeti i vrare njeri prej tyre, i cili me vone u identifikua si personi me emrin Ludovik Burgaj. Vete pronari i lokalit ne fjale, Bahri Rragami tregon detaje rreth kesaj ngjarjeje. Per gazeten tone ai tregon se pas ngjarjes, familjaret e viktimes Ludovik Burgaj, nen kerconime te hapura per jeten, u kane kerkuar atij si dhe kamarierit Elsaid Sala te tregojne emrin e agresorit qe vrau njeriun e tyre. Nga ana tjeter, edhe familjare te agresorit i kane kercuruar me jete qe te dy, nese do te tregojne ndonje gje ne lidhje me ngjarjen. Sic deklaroi pronari Rragami, as ai dhe as kamarieri i tij, nuk i kane njohur agresorin dhe as viktimen. Pas kesaj situatë rende te krijuar, nen kerconimin e vazhdueshem te familjareve te viktimes por edhe te familjes se vrasesit, Bahri Rragami eshte detyruar te mbylle te gjithë aktivitetin e tij tregtar dhe nga ajo kohe te qendroje i fshehur si klandestinin ne Shqiperi. Punonjesi i tij Elsaid Sala, pas shume kerconimeve dhe disa tentativave per atentate ndaj tij nga palet ne konflikt, u detyrua te largohet jashte Shqiperise, por per vendndodhjen e tij askush nuk eshte ne dijeni. Mesojme se te afermit e tij ne Shkoder, jane te ngjuar nga frika e hakmarrjes ndaj tyre. Sic ndodh rëndom ne raste te tilla, futet ne loje Kanuni i Lek Dukagjinit, i cili prej me shume se 22 viteve ka treguar me fakte se eshte mbi ligjin ne Shqiperi. Plaga e gjakmarrjes eshte bere nje teme nderkombetare, tekasa edhe media prestigjioze nderkombetare si "Corriere della Sera" kane investiguar duke treguar se numri i te vraveve per gjakmarrje ne Shqiperi gjate 22 viteve te fundit, eshte mbi 10 mijë. Fatkeqesisht, edhe fati i Elsaid Sala eshte tashme i lidhur me zbatimin e ketij kanuni famekeq nder shqiptaret. **Redaksia**



“Të Pastrehët me Status”, një mashtrim dhe vjedhje kolosale Shtet + “Të pastrehë” në dëm të pronarëve qytetarë!

Nga Agron Luka

Historia e “Ç”pronësimit dhe Strehimit” të këtyre “Të Pa Strehëve”, për afro 5 dekada në kohën e Partit-Shtetit tashmë dihet dhe kjo analizë është jashtë objektivit këtu.

Rreth 21 vjet mbas vendosjes së njëfarë demokracie në Republikën e Shqipërisë është një megaskandal të dëgjosh udhëheqësit e dy partive dhe të partitçkave, duke zhvilluar debate me hipokrizitë dhe mashtrimet e tyre rreth problemit të rregullimit të “Pastrehëve me Status” dhe çështjes së rikthimit fizik të banesave, të ashtuquajturve si “ish pronarëve” qytetarë. Më konkretisht është fjala për Aktin Normativ të Këshillit të Ministrave, për detyrimin e të “Pa Strehëve me Status” për të marrë kredi me zero interes dhe për t’ia liruar banesat më në fund pronarëve të ligjshëm qytetarë, mbas datës 1 nëntor 2012.

Me vendosjen e demokracisë shteti shqiptar rregulloi me “Statuse Pa Strehë”, disa mijëra familje, duke i shoqëruar me VKM të ndryshme, ku përcaktosheshin se sa përqindie do u depozitonte shteti në banka, sa përqindie do i paguante “ish pronarëve” të rikthyer si pronarë të ligjshëm etj.

Në fakt shteti shqiptar me dhunë dhe pa asnjë lloj kontrate me pronarin e ligjshëm, imponoi një lloj zgjidhje “alla tranzicioni”, duke mos vendosur asnjë lloj afati kohor etj. Piksëpari vetë shteti i shkeli të gjitha detyrimet e veta, duke u justifikuar me “Trazirat” etj, dhe nga këndej edhe “Të Pa Strehët” u trimëruan aq shumë sa që nuk begenisën t’ia paguanin pronarëve të ligjshëm, as atë të ashtuquajturën qera simbolike që u kishte caktuar shteti filantrop shqiptar! Në fakt shteti shqiptar ishte filantrop dhe dukej si “shtet social”, por realiteti ishte se ky shtet ka dhunuar rëndë pronarët e ligjshëm qytetarë.

Përfundimi dihet: “Të Pastrehët” realisht kanë

mbi dy dekada që nuk i paguajnë “ish pronarëve/pronarë”, asnjë lloj qeraje, ndërsa edhe shteti shqiptar ka mbi dy dekada që nuk ka harxhuar asnjë kacidhe, për këto të mbeturit e fundit “Pa Strehë”!

Se sa shkente ky dëm në vlera monetare, në dëmmin e pronarëve qytetarë, shteti dhe llogaritarët e shtetit as nuk e kanë vrarë mëndjen fare! I vetmi shqetësim i zëdhënësit të qeverisë ishte se sa do mund të shkente dëmi, po qe se pronarët e ligjshëm do e padisnin qeverinë në Gjykatën e Strasburgut!

Se që Gjykatat tona, apo i ashtuquajturit Avokati i Popullit t’i hynin kësaj çështje kaq flagrante qoftë edhe vetëm si diskutim, as që bëhet fjalë!

Për Avokatin e Popullit aktual na u shkaktokan “probleme sociale”, vetëm po të preken “Të Pastrehët”, duke lënë të kuptohet qartë se dhunimi i pronarëve ligjorë të këtyre banesave, jo vetëm nuk është aspak “problem social”, por edhe më cinikisht këta nuk konsiderohen as si popull!

Ndërkaq po t’i hyjmë dhe t’i shoshisim këto “Të

Pa Strehë” të mbetur, flasim për qytetin tonë, do gjejmë edhe nga këto raste xhevahire e paradoksale:

1. “Të Pa Strehët” janë pjestarë trashigimtarë nga ish pronat shtëpi, tokë, shpronësim etj dhe ato i kanë marrë dhe i marrin pasuritë e tyre, atje ku i kanë tringjet trashigimtare.

2. “Të Pastrehët”, kanë ish Kontrata-Qeraje me ish shtetin e socializmit në emrin e ish kryefamiliarit të vdekur para vitit 1990, dhe ndonëse kanë marrë një ose dy banesa falas, pretendojnë akoma sot, krye për emër, simbas çertifikatës familiare dhe shtesës familiare, shtëpi falas, duke mos ua liruar shtëpitë pronarëve të ligjshëm!!! Nuk ua liruan edhe kur ata vetë si familie me kryefamiliar të ri nuk kanë as Status e as kërkesë për kredi!

(vijon në numrin e ardhshëm)


Në dhjetë ditë vriten katër gra

Në dhjetë ditë e fundit në Shqipëri, katër grave u është marrë jeta nga burrat dhe ish burrat e tzre. Shifrat e dhunës në familje po rriten frikshëm nga viti në vit: Të dhënat e Statistikave të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë në Tiranë tregojnë se dhuna ndaj grave është alarmante dhe burrat, dhunuesit, vrasësit nuk dënohen, por masat për të mos u ofruar me shume se 500 meter apo një kilometer afër viktimës, sipas shkalës së rrezikshmërisë nuk ka funksionuar, pasi policia nuk është në gjendje të kontrollojë burrat e dhunshëm.

Më konkretisht, në vitin 2008, ka pasur 822 denoncime për dhunë në familje dhe për 377 prej tyre gjykata ka lëshuar një urdhër mbrojtje. Por vit pas viti numri i grave që u drejtohen autoriteteve të policisë për të denoncuar dhunën që ushtrohet mbi ta, brenda në familje, thuhet është trefishuar. Kështu në fund të vitit 2011 plot 2.181 gra kanë denoncuar në polici dhunën që ushtrohet ndaj tyre, ndërsa gjykata ka lëshuar plot 1.343 urdhra mbrojtje për to. Por shumë më rrëqethëse janë shifrat jozyrtare, pasi shumica e grave dhe vajzave të dhunuar nuk denoncojnë fare në polici, por ose i binden dhunës, ose përpiqen të largohen vetë dhe shumë prej tyre bëhen viktime deri në vrasje. Kjo tragjedi është shumë e dukshme në zonat e Veriut dhe të Juglindjes Shqiptare. Kohët e fundit një grua nga Laçi, e quajtur Mafilda Martin Dakaj, e datelindjes 07. 04. 1990, për pak i ka shpëtuar vrasjes nga ish burri i saj Alfons Dedaj. Ajo kishte qene e martuar dhe duke e rrahur kafshërisht burri, i cili shkente i alkoolizuar në shtëpi, kishte ikur nga shtëpia e burrit dhe e kishte paditur në Gjykatë. Gjykata nuk ka marrë asnjë masë mbrojtëse vetëm se i ka njohur divorcin. Por edhe pas divorcit, kur nuk kishte asnjë lidhje ligjore me shtetasen Mafilda Dakaj, ish burri nuk heq përsëri dorë. Vazhdon dhunën fizike ndaj saj, saqë viktime i është nënshtruar mjekimit në shtëpi nga mjeku i njohur Zeqir Dukaj, pasi sipas të atit të saj, shtetasit Martin Dakaj, nuk mund ta transportonte drejt spitalit, pasi ish burri i saj atje edhe mund ta vrasë. Në fakt në spitalin e Shkodrës, njerëz ende të paidentifikuar edhe pas shumë vitesh paten arritur të pushkatojnë edhe mjekun Zamir Shazi, emrin e të cilit mban sot Spitali Rajonal i kryeqendrës së Veriut Shqiptar, Shkoder. Ndërsa gjendja spitalore në Laç është tepër më e pasigurtë se edhe në Shkodër.

Iris Luarasi, drejtuese e “Linjës për Këshillimin e Grave dhe Vajzave” u bën thirrje gjithë grave e vajzave të mos pranojnë dhunën nga burrat apo ish burrat e tyre, por të marrin në telefon pa pagesë dhe të kërkojnë ndihmë.

Gjithsesi, edhe kjo thirrje e zonjës Luarasi nuk e gjykojmë se si funksionon për zonat shumë të largëta të veriut të Shqipërisë, pasi do duheshin deri në 12 apo 15 orë rrugë për të shkuar drejt Tiranës, ku zonja Luarasi ka zyrat e saj.



Redaksia

Ne Shqiperi ka 6500 persona te ngujuar apo te fshehur nga gjakmarrja


Problemi i ngujimit apo i fshehjes pa adrese nga frika e gjakmarrjes ne Shqiperi, eshte kthyer ne nje makth per dhjetera familje shqiptare. Jane shoqatat e pajtimeve ato qe vijojne ti bijne kembanave te alarmit ne nje vend ku shteti eshte inekzistent. Komiteti Mbarekombetar i Pajtimimit te Gjaqeve thekson se jane 6500 persona qe rezultojne te fshehur apo te ngujuar ai pasoje e gjakmarrjes. Kryetari i ketij misioni, Gjini Marku thote se gjate nje viti numri i te vrareve ne emer te gjakmarrjes eshte mbi 150, ku shqetesuese eshte edhe vrasja e grave. Ajo cfare eshte me tragjike ne kete tablo, eshte pamundesia e pajtimimit ne mes familjeve, edhe kur nuk ka te vdekur por vetem te plagosur me arme te ftohte (thike). Shoqata Misionaret e Paqes dhe Pajtimeve me qender ne Shkoder evidenton nje ngjarje te vitit 2010, e cila akoma nuk eshte mbyllur me gjithë perpjekjet e tyre per pajtim. Ishte data 2 qershor 2010, kur shtetasi Rifat Dani plagos ne kembe me thike shtetasin Luan Hysni Plozha. Babai i Luanit, I quajtur Hysni Plozha ka takur pas pak kohesh ne lagjen “Rus” te Shkodres ate qe i kish plagosur djalin, shtetasin Rifat Dani, te cilin e ka goditur me mjete te forta duke i shkaktuar gjakderdhje. Ne keto kushte, Rifat Dani eshte shprehur se do ti vrase te dy, babe e bir. Shoqata Misionaret e Paqes dhe Pajtimeve thote per gazetën tone se jane bere perpjekje per ti pajtuar keta shtetas mes tyre. Rifat Dani nuk pranon te shtrije doren e pajtimimit, por i eshte shprehur Misionareve te Pajtimimit se “kerkon te marre hak sipas Kanunit te Lek Dukagjinit”. Ky kanun famekeq, i cili fatkeqesisht eshte me i forte se ligji tek shqiptaret, ekziston prej mese 600 vitesh dhe ka krijuar probleme dhe konflikte te herepashershme. E rrezikuar me jete eshte edhe motra e Luanit, e quajtura Merita Plozha, e cila sot nuk ka nje adrese, jeton ne ilegalitet apo ne nje vend ku mendon se nuk e ka te rrezikuar jeten. Kercenimet per Luanin dhe familjen e tij jane te shumta dhe cfare eshte me tragjike ne kete histori, shteti eshte dorezuar para gjakmarrjes e Kanunit. Si mijera te tjere, Luani, motra e tij Merita dhe pjestare te familjes, nuk dihet se ku jane, por nje gje eshte e sigurte: ne vendlindjen e tyre Shqiperi, jeta e tyre eshte e kercenuar nga vdekja, pasi konflikti eshte akoma i hapur. Tashme fenomeni i gjakmarrjes ne Shqiperi eshte bere i frikshem, ku vetem 20 vitet e fundit jane vrare rreth 20 000 shqiptare.



Redaksia

Qëllohet me armë zjarri anëtari i Partisë Fryma e Re Demokratike dhe dy shokët e tij: Ngjarja e pazbardhur

Partia Fryma e Re Demokratike, një parti e qëndrës së djathtë, e cila tashmë është shtrirë në të gjithë Shqipërinë, e drejtuar nga ish Presidenti i Republikës Bamir Topi, po e zhvillon aktivitetin politik nën presione e dhunë, deri edhe në atentate e vrasje. Pikërisht dje, kryetari Topi denoncoi nga Shkodra dhunën ndaj anëtarëve e simpatizantëve të kësaj force politike dhe fali me tone të ashpra kundër kryeministrit Sali Berisha, duke e akuzuar për klimën kriminale të krijuar në Shqipëri. Ngjarja më e rëndë dhe e pazbardhur mbetet ajo e 4 marsit 2012, ngjarje që tronditi Malësinë e Madhe. Një 33 vjeçar mbeti i vraë dhe një tjetër i plagosur në një lokal në qendër të fahatit Vukel më 4 mars 2012. Krimi është regjistruar rreth orës 20 e 30 minuta të mbrëmjes, në fshatin e largët Vukël të Komunës Klmend. Viktima, Gjovalin Vuçinaj, 33 vjeç ka ndërruar jetë në vënd si pasojë e plumbave të armës së zjarrit dhe i plagosur ka mbetur 45 vjeçari Bardho Grishaj. Ndërsa 19 vjeçari Artur Grishaj, i cili po pinte kafe me të pushkatuarin dhe të plagosurin, falë Zotit e fatit ka shpëtuar mrekullisht nga plumbat, duke u tronditur psikologjikisht. Fillimisht policia ka vepruar shumë ngadalë, pasi fshati Vukël ku u shënua ngjarja ndodhet rreth 20 kilometra larg qëndrës së Komunës Kelmend të Malësisë së Madhe dhe rreth 4 orë larg me makinë nga qyteti i Koplikut. Terreni për atje është vërtetë i vështirë. Forcave të rëndit u janë dashur disa orë të mbërrijnë në vëndngjarje. Ato janë lajmëruar nga një banor i zonës për krimin, çka ka bërë që drejt vëndngjarjes të nisët grupi hetimor. Në fakt, autorët e kësaj ngjarjeje të rëndë kanë qëlluar nga jashtë lokalit drejt dy kushërinjve Grishaj dhe shokut të tyre Vuçinaj, duke e vrarë këtë të fundit, plagosur Bardho Grishaj dhe shokuar Artur Grishaj. Pasi kanë qëlluar disa herë në drejtim të tre burrave, autorët duke përfutur nga errësira dhe largësia me qëndrat e tjera të banuara, si dhe nga largësia e Komisarariatit të Policisë së rrethit Malësi e Madhe, janë larguar për në drejtim të paditur. Në fakt autori i krimit është identifikuar shpejt. Versioni i vrasjes tashmë dihet. Nuk kanë qënë shënjestër e plumbave as i vrari, as i plagosuri, por Artur Grishaj. Artur Grishaj, foton e të cilit po e publikojmë sot, për shkak të aktivitetit politik me Partinë Fryma e Re Demokratike ka qënë në shënjestër për tu pushkatuar. Kjo ngjarje kaq e rëndë nuk ka ende të dënuar me burg, çka edhe drejtuesit e Frymës së Re Demokratike, duke filluar nga kryetari Topi e deri në bazë, e ndjejnë rrezikun përgjatë aktivitetit të përditshëm, ndaj edhe gjuha e ashpër duket se është e motivuar për këtë forcë politike që po vazhdon që tani fushatën për zgjedhjet e ardhshme parlamentare nën një presion e dhunë të pashembullt.



Sokol Pepushaj

Familja Murej dhe hakmarrja mesjetare

Shqiperia, veçanërisht Veriu i saj ku kanuni mesjetar i lekë Dukagjinit ka lënë tashmë krejt në hije ligjin edhe për faktin se kriminelët lirohen nga gjykatat, siç ngjau edhe me vrasësin e Kryekomisarit të Shijakut Adem Tahiraj kriminelin Ilir Xhakja, është një vater e nxehët krimi. Xhakja, një killer serial, i njohur nga drejtësia shqiptare ishte arrestuar shumë herë. Herën e fundit, megjithëse dënohet 21 vjet bur për vrasje, pak pas dënimit fiton lirinë dhe vret sërish. Edhe vetëdorëzimi i tij pas vrasjes së kryepolicit dhe plagosjes rëndë të shoqëruesve të tij, po perflitet nga tërë mediat e pavarura shqiptare se u shty nga politikanë të lartë që kanë lidhje të ngushta me killerin. Ajo çka e bën gjëndjen tepër shqetsuese është se perflitet se sado të dënohet për ngjarjen, ai sërish do gjejë një gjykatë ti japë pafajës. Thujse përditë vriten njerëz të pafajshëm për gjakmarrje. Gjëndja është shumë e zymtë sa po ppushkatohe edhe gra e fëmijë dhe po kështu edhe gratë kanë marrë pushkët e vrasin. Kështu, rasti i 17 vjeçares Marije Quku dhe gjyshit të saj 70 vjeçarit Kolë Quku që u pushkatuan teksa po punonin tokën pranë shtëpisë së tyre në lagjen Kasnec të fshatit Kir të komunës Pult në Dukagjin të Shkodrës, nga tre pjestar të familjes Prroj, apo vrasja tjetër ku Lena Pjollli, nënë e dy fëmijëve pushkaton krejt e qetë me 6 plumba model 56 shtetasin Marash Tonaj dhe më pas vetëdorëzohet në polici e flet me krenari për vrasjen, janë pak nga pamja e këtyre ditëve në Shqipëri.

Viktimitë e kësaj pamjeje të zezë me emrin gjakmarrje është edhe shtetasi Fatbardh Xhabir Murej, gruaja e tij Suela dhe dy vogëlushët, djali Ardis vetëm 12 vjeç dhe vajza Isra, vetëm 7 vjeçe.

Zanafilla e hakmarrjes është vërtet banale,



por në Shqipëri Kanuni ka kode që jo vetëm zbatohen, por edhe tejkalohen, siç është vrasja e femrave e fëmijëve që në fakt Kanuni nuk i ndëshkon.

Fillimi i konfliktit të hasmërisë i takon vitit 2001.

- "Fatbardh Murej, me banim në lagjen "Naim Gjylbegu", ka kapur duke vjedhur në shtëpinë e tij shtetasin Mehdi Haxhia me banim në lagjen "Fahri Ramadani" dhe janë përleshur fort me njëri-tjetrin. Nga ky konflikt shtetasi Mehdi Haxhia mbetet i goditur rëndë. Më pas ai del përpara dhe qëllon të atin e Fatbardhit me mjete të forta duke i shkakuar plagë të rënda, i cili më pas humb edhe jetën ...", deklaroi zyrtarisht Shoqata Misionarët e Paqes dhe Pajtimeve të Shqipërisë nëpërmjet dokumentit zyrtar të tyre me Nr. 60 të Protokollit, të cilën gazeta jonë e disponon. Nisur nga kjo, investiguam rastin në fjalë. Vërtet, i ati i Fatbardh Murej, shtetasi Xhabir Murej, më datën 28 nëntor 2003, rreth 100 meter afër



shtëpisë së tij është qëlluar me mjete të forta. Shumë shpejt ka përfunduar në Spitalin Rajonal të Shkodrës dhe fatkeqësisht nuk u ka rezistuar plagëve, por ka ndërruar menjëherë jetë. Kjo ngjarje ne na rezultoi ende e pazbardhur. Por të tilla ka shumë në Shkodër, pasi shteti nuk ekziston fare, pasi kriminelët kanë suport politik dhe ekonomik, pasi gjykatat jo vetëm nuk i dënojnë, por flitet se vetë policia dekonspiron shpesh edhe ndonjë denoncim të mundshëm, ku kriminelët mëpastaj hakmerren.

Mbi familjen Murej dhuna është e vazhdueshme dhe e egër. Më 10 gusht 2011, persona ende të pidentifikuar, kanë hyrë në shtëpinë e Fatbardh Murej dhe aty kanë gjetur vetëm nënën e tij, një plakë të lodhur nga jeta, ku komshijtë tregojnë se ka patur edhe probleme shëndetësore. Të moshuarën e kanë rrahur për vdekje, si në filmat horrorë. Pas pak gruaja ka ndërruar jetë. Është edhe ky një krim i pazbardhur ende dhe duket as do zbardhet kurrë.

Por edhe ditët e fundit, pikërisht më 6 shtator 2012 persona të panjohur kanë vëndosur dhe shperthyer një sasi lëndë plasëse tek dera e shtëpisë së shtetasit Fatbardh Murej. Për fat nuk kishte viktima në njerëz, përveçse dëme materiale. Në të vërtetë shpërthimi i lëndëve plasëse, sidomos ato që komandohen me celular janë shumë të shpeshta dhe kanë marrë jetë të shumta njerëzore.

Një shpërthim me telekomandë mëngjesin 13 tetorit 2011, që ndodhi në mes të qytetit të Shkodrës, pati marrë jetën e personit që ishte vënë në shënjestër. Viktima Mark Gjoni, kambist, pat gjetur vdekjen ndërsa makina e tij u shkatërrua nga forca e shpërthimit në vendin e quajtur "Tregu i Valutës", në afërsi të Kishës Ortodokse. Policia e Shkodrës bëri të ditur se ngjarja, që shkaktoi panik në të gjithë zonën, ndodhi rreth orës 06:30. Viktima, ish-oficer ushtrie, pak minuta më parë kishte dalë nga banesa për të vijuar punën e përditshme me të cilën siguron të ardhurat e familjes së tij. Pasi ka pikasur një vend bosh diku nga fillimi i rrugës "Hasan Riza Pasha", ai ka filluar të manovrojë në mes dy automjeteve për ta parkuar makinën e tij, tip "Benz 2400c", me targë SH 1465 E. Por, sapo ka përfunduar manovrën e fundit të parkimit dhe ka fikur mjetin në tentativë për të dalë prej saj, makina ka shpërthyer, duke e zhvendosur trupin e tij disa metra në anën tjetër të rrugës. As për këtë ngjarje nuk ka zbardhje dhe sipas investigimeve tona është mbyllur dosja për të mos u hapur më, megjithëse tragjedia është me elementë terroristë dhe regjistrohet në mes të qytetit të Shkodrës.

Redaksia

Selcë-Kelmënd: Ndëshkimi i një flligështije në gjak (inçest) nën shkëmbinjë e rrënoja, sipas një gojëdhëne

Rreth gjysem kilometri larg nga Kisha e Selces, bri rruges që shkon për në Vermosh, në vendin e quajtur Jasanovë shihet një grumbull i madh gurësh dhe shkëmbinjesh (me një sipërfaqe rreth 7000 m²). Keta shkëmbinjë janë të permasave të ndryshme, dhe mbulojnë krejt këtë sipërfaqe në një trashësi mesatare 4-6 metra. Shkëmbinjët kanë "zbritur" nga faqja e malit ngjitur, duke rënë si orteqe të mëdha, në një kohë "Kjame-ti". Sipas një gojëdhëne (që gjindet edhe sot te banoret e Kelmendit), mesohet se qindra vite më përpara (mendohet para pushtimit turk të Kelmendit, pra para vitit 1497) ketu banonin dhjetra familje, me lidhje të afërta gjaku, të cilët sipas tradites nuk martoheshin kurrë me njeri tjetrin. Mirpo një ditë dy të rinjë e thyejnë këtë "tabu", dhe pasi dashurohen vendosin të martohen. Opinioni i banoreve ketu dhe prifti mundohen ta ndalin këtë inçest, apo flligështi në gjakë siç i thonë malësoret



,por kjo ishte e pamunduar. Dy të rinjë e dashuroar caktojnë ditën e dasmes, dhe ftojnë të gjithë banoret e ketij katundi (nese mundë ta quajmë kështu). Në atë dasëm nuk pranoi të shkojnë vetem prifti dhe kovaçi. Diku nga mesi dasmes (mendohet të ketë qenë natën) në menyrtë të befasishme nga lartësitë e malit perballë filluan të shkeputen gurë e shkëmbinjë të medhenjë që u ngjanin orteqeve gjigande, të cilët vershuan mbi shtëpinë ku bëhej dasma dhe shtëpiat e tjera, ku në pak minuta gjithshka u rrafshua e mbulua nga ata shëmbinjë që shohim sot. Thuhet se shpetuan gjallë vetem prifti dhe kovaçi që nuk kishin shkuar në dasëm, ndërsa të tjeret as nuk u panë as dëgjuan kurrë më. I vetmi zë jete nën keta shkëmbinjë e rrënoja kishte mbetur për pakë ditë "kënga" e një gjeli që thuhet se "kendoi" deri sa kishte ushqim, e pastaj edhe ky zë ia ka lënë vendin heshtjes së amshueme për shekuj, heshtje e cila vijon të qendrojë edhe sot nën shkëmbinjë e rrënoja. Sipas gojëdhënes edhe sot "besohet" se ky ka qenë një ndëshkim i vetë Zotit, për të gjithë ata që bënë apo mbështeten këtë flligështi brenda një gjaku, fisi apo të afermëve, gjë që nuk e lejonte as feja dhe as morali kristian... Gjithsesi kjo është një gojëdhënë që ende deri sot qendron e pa eksploruar, "nën" keta shkëmbinjë e rrënoja.

Ndue Bacaj

Gjakmarrja shkatërron familjen Sheqeri

Gjakmarrja, ky fenomen tashme i pranuar publikisht nga Kisha Katolike dhe kryeministri Berisha po shkatërron jetet e qindra familjeve në Veriun e Shqipërisë. Familje te tera, pasi humbasin nën plumbat e gjakmarrjes njerëzit me të dashur, detyrohen të ngujohen për të shpëtuar vargut të gjate të hakmarrjes. Armando Sheqeri, 22 vjeç është rasti i rradhes i kesaj cmendurie kolektive nder shqiptare. Armando është antar i nje familje te madhe tradicionale shqiptare. Ai ka dy motra Besara 20 vjece, Blerina 17 vjece dhe nje vella Besmiri 25 vjec, te cilet jetojne me nenen e tyre 47 vjecare Hydajete. Prej kohesh ne familjen e tyre mungon kryefamiljari Ymeri, i cili eshte nje nga viktimat e gjakmarrjes.

Historia e kesaj familjeje eshte e dhimbshme dhe mund te konsiderohet tragjedi e rradhes e gjakmarrjes. Cdo korrik, kjo familje kalonte 15 diteshin e pushimeve ne plazhin e Velipojes. Po pikërisht ketu, ne 15-diteshin e pare te muajit korrik 2008, ze fill shkatërrimi i kesaj familjeje. Teksa Armando me vella dhe dy motrat kishin dale pasdite per nje kafe ne nje nga lokalet e plazhit, 3 persona te panjohur per ta por qe flisnin me dialekt te rende verior, ngacmojne motren e madhe Besara. Ata perdorin fjale fyese ne drejtim te Besares dhe natyrisht vellezerit Armando dhe Besmir i kerkojne te shohin punen e tyre. Ketu nis konflikti, i cili precipiton ne ngacmime fizike, deri ne goditje me grushte ku njeri nga te panjohurit rrezohet ne toke i gjakosur pasi perplas koken ne nje tavoline te lokalit. Nderhyrja e klienteve te tjere, i jep fund konfliktit, ndersa personat e panjohur leshojne ne drejtim te familjes Sheqeri kerccenime te ndryshme si dhe "na keni nxjerre gjakun, na keni gjakun borxh". Duke e menduar nje histori te parendesishme, Armando, vella dhe motrat e tij vijojne pushimet ne Velipoje.

3 prsonat e panjohur nuk e konsideronin te mbyllur kete ceshtje. Rreth 2 muaj me vone, me 15 shtator 2008, ata kishin vendosur te merrnin hak. Babai Ymeri dhe dy djemte e tij Armando dhe Besmir, pas xhiros se zakonshme ne kohe vere, ktheheshin ne shtepine e tyre ne periferi te qytetit te Shkoder tek ish- Fabrika e Mendafshit. Rreth 250 meter pa mberritur ne banesen e tyre, nje bresheri automatiku nga nje makine qe levizte me shpejtesi, qellon ne drejtim te tyre. Nga plumbat bie ne toke i vdekur babai Ymer Sheqeri, ndersa plagoset lehte ne krahun e djathte Armando Sheqeri. Vellai tjetër Besmiri shpeton nga plumbat. Vetem pak dite pasi kishin percjelle ne banesen e fundit babain, Armando merr nje telefonate anonime ne celularin e tij. Fjalet ishin te shkurtra: "Shenjstra jone nuk ishte plaku juaj, por ju, djemte e tij qe na gjakoset ne Velipoje". Ky moment solli fillimin e ngujimit per Armandon dhe vella dhe tij, te cilet nese do te dilnin, do te kishin fatin e babait te tyre. Ngujimi sjell pasoja te renda ekonomike edhe per familjen. Barra e familjes nuk mund te perballohej nga ema dhe motrat, pasi meshkujt nuk mund te dilnin nga shtepia per te siguruar jetesen. Megjithate, edhe levizjet e grave te familjes ishin te kufizuara, pasi ne emer te gjakmarrjes jane vrare shume gra e vajza ne Veriun e Shqiperise. Ne rrethana te pasqaruara, njeri nga vellezerit Sheqeri, i quajtur Besmir, ka arritur te largohet tashme nga vendlindja. I rrezikuar per jeten mbetet Armando Sheqeri, i cili ka mbetur i ngujuar dhe i pashprese ne kullen e ngujimit, ne kete kulle ku po gjejne vdekjen dite pas dite me qindra shqiptare te pafajshem. Njeri prej tyre eshte Armando Sheqeri.



Zef Nika

Nëpër magjitë e Shkodrës

Nga Sokol Pepushaj

Për ty që nuk e ke vizituar prej të paktën 5 vitesh Shkodrën, duhet të vihesh në kërkim të imagjinatës, në kërkim të rikthimit të kujtesës që të duket se të ka tretur larg, fort larg, në tis të mjegullt vegimesh. Ai qyteti i vakët që flinte sa binte akshami e çohej i përgjumur në mëngjes për tu çapitur deri në akshamin tjetër e për të vazhduar ritualin, tashmë nuk ekziston.

Është rilindur Shkodra, është rritur e stolitur, ose, artistikisht, instrumentalizuar, siç mund të shprehej me gjuhën e artit muzikanti i famshëm Kujtim Alija, puna e të cilit i ka kaluar prej vitesh jo vetëm kufijtë e Shkodrës, por edhe të Shqipërisë.

Dy "VESHKAT" e qytetit, Kisha Françeskane e Gjuhadorit dhe Xhamia e Fushë-Çelës (sot Ebu Bekër) me rastin e 1 vjetorit të Pavarësisë, pra më 28 nëntor 1913, patën një event, unik në botë.

Kambanorja u lidh me Minarenë me një konop në të cilin u varën dritat me rreshtin e gjatë të kandilave kuqezi e ku u valëvit Flamuri ynë Kombëtar. Shpresojmë që këtë 28 Nëntor, në 100 vjetor të Pavarësisë, Bashkia të mendojë një event, pasi Shkodra ka mundësi të jetë unike, si 99 vjet më parë. Mbase mirë do ishte të vihej në skenë një shfaqje e përbashkët mes dy komuniteteve fetare, katolikë e myslimanë, pse jo në përgjigje të filmit të debatueshëm me titull...

"PAFAJËSIA E MYSLIMANËVE"...

që u shfaq ditët e fundit në Amerikë dhe ndezi demonstrimet në tërë botën islame, ku po humbin shumë jetë të pafajshme njerëzish si rezultat i kundërshtive të talljes me Profetin Muhamedit.

Kisha e Xhamia që dikur qenë lidhur bashkë me drita nga frati e hoxha, tashmë janë plotësuar me nota identiteti, pasi aty pari, simethënë në mes, grupe vizitorësh të huaj pëditë shkrepin blicet para Shtatores së Nanë Terezës, nënës më të famshme e më humane që njeh Bota deri sot.

Mbi identitetin bazë, damarët e Shkodrës me rrugë të gjëra e të pastra, me infrastrukturë klasike e moderne, i ngjajnë një trupi të shëndetshëm të shkrirë një me njeriun, me nevojat e tij. Në këtë linjë, shpeshherë arkitekti i njohur Zef Çuni që pat kundërshtuar fort Projektin e Ndërtimit në

qëndër të qytetit të Shkodrës dikur, e sheh me butësi e elegancë, madje si një format krijimtarie dhe ëndërr ideali të njeriut,

Në thelb, politika e egër, rrënat e broçkullat thjesht si instrument përdorimi, klanet mafioze me tenderimet, kanë vdekur në

fitojnë e pak të ndertojnë.

Mes ndjenjës së mrekullisë e magjisë, mes befasisë e bukurive si këtu, gjen mjaft njerëz ku



këtë infrastrukturë ku janë shtrirë rrugët, ku rrethrotullimet e shumta e lulishtet janë kudo nëpër udhët e gjëra të qytetit që po merr imazh perëndimor. Në biseda të lira, jo vetëm Çuni, por edhe arkitektë të tjerë janë për pak lopata më pak beton e për pak më shumë vëmendje nga Bashkia për mëndimet e projektet e tyre, domethënë të gjithsecilit.

Shkodër prej atij që edhe autori i këtyre radhëve nuk mund ta besonte asokohe kur Shkodra lëngonte, 5 vjet më parë.

Me punën e dukshme që flet, kryebashkiaku Lorenc Luka dhe stafi i bashkisë kanë arritur që e vërteta ta eklipsojë maminë e dukjes sipërfaqësore apo laro-shitë e medimeve që rëndom sorollateshin nga shumë asish që dinë shumë të kritikojnë e për-

diskuton me ta, jo si para pesë vitesh për gjeneratorë, për gropa e baltë...

KALLASHNIKOVËE BANDA...

por për gjithçka lidhet me identitetin e kulturën e këtij qyteti. Që nga Tempulli i Rozafës, meshari i Gjon Buzukut, Marin Barleti, Pashallaku i

Shkodrës, Karl Gega, Kel e Pjeter Marubi, Lahuta e Fishtës, nga poezitë e Ernest Koliqit, Arshi Pipës, Martin Camajit, Frederik Reshpes, Ridvan Dibrës, nga librat e Jup Kastratit, Skender Drinit, Pjeter Arbnorit, Shpetim Kelmendit, Dashmir Cacës, Zenepe Dibrës, Lazer Stanit, Nikolla Spatharit, Xhaneta Lazri, Fatime Kullit, Skënder Temalit, nga librat e pavdekshme të Babës së Dramës Shqiptare Fadil Kraja, nga rolet e aktorëve të mëdhenj të skenës si Ndreke Luca, Tinka Kurti, Serafin Fanko, Viktor Bruçeti, Zyliha Miloti, Zef Deda, nga humori i Tano Banushit, Paulin Selimit, Kolec Pepës e deri tek këngët e Bik Ndojës e Shyqyri Alushit apo vokali i ish tenorit ndër më të famshmit në Europë Lukë Kaçaj, mund të diskutosh edhe para një tave me krap liqeni që gatuhet më mirë se kudo.

E, qyteti plot e përplot histori, plot e përplot legjenda e mite, plot e përplot kapacitete intelektuale, sot nuk ka një rrugë ku nuk është punuar a po punohet. Shumë sheshe tashmë janë me kalldrëm të gjërë duke ruajtur strukturën, veçmas atë austriake ku më 1914 pat marrë format europian, duke ruajtur traditën e një bahçeje me lule, ku porta e Shkodrës, e hapur në jetë të jetëve për miqtë dhe e mbyllur për pushtuesit, Bahçalleku, ka emer bahçeje, emer të një lëndine lulesh. Këtu në portë të Shkodrës, pasi thua...

"A KE BUKË ME NA DHANË"...

e përgjigja vjen "Sa ka deti ujë e ranë", është pra Bahçja e lashtë sa Toka, sa Drini, sa Buna, Bahçalleku. Kalaja me moshë rreth 30 vjet më të re se Nusja Shkodrane Rozafë, Nana Shkodrane Rozafë që u muros këtu për të mbajtur muri që ditën ndërtohej e natën rrëzohej e u flijua për tu ndërtuar Shkodra mbi shtatin e saj, i takon të jetë nja 400 vjet më e lashtë se Jezu Krishti.

Qyteti i Shkodrës tashmë është krejtësisht i ndriçuar.

Shumë rrugë janë vërtet të magjishme, janë pedonale. Ja rruga nga Kafja e Madhe (objekt i cili veçse është privat ka mbetur si një shëmti mes parajsës dhe mendojmë se bashkia duhet ta gjejë një zgjidhje pasi ka statusin e Monumentit të Kulturës) e deri tek Univesrsiteti "Luigj Gurakuqi", kjo tjetra tek Ura e Bunës, kjo nga rrapi 400 vjeçar afer Radio Shkodrës e deri tek Tregu i Zdralajve, apo nga ish Dugajt e Reja në Gjuhador. Ja edhe rruga tjetër pedonale që është në ndërtim dhe perurohet diku pas një muaji që nis në Par-



rucë e bashkohet me pedonalen tjetër bash në kryq të kryqëzimit të qendrës së Shkodrës, këtu ku jo shumë larg në kohë, bënte demonstrim force Monumenti i Stalinit. E parkuam pëndën edhe tek diktatori Stalin, për të hequr paralele mes persekutimit komunist në Shkodër e atij në Rusi.

Vitet e hetuesisë, burgut dhe vëjtjes së klerit katolik në kampet e shfarosjes komuniste janë ke 881 vite, ose gati 9 SHEKUJ. Prej 200 klerikëve shqiptarë në vitin 1944, janë pushkatuar dhe mbytur ndër burgje 66 klerikë, arrestue dhe vëjtë shumë vite burg janë 65. Gjithsejt 131 klerikë katolikë Vetëm këta kanë kryer studimet e larta në 24 Universitete të

ndryshme të Evropës ndër 450 vjet studime. Të gjithë janë përfshi në GENOCIDIN KOMUNIST NË SHQIPËRI. Gati tërë ky persekutim është kryer në Shkodër. Një tragjedi e pashoqe është edhe në klerin mysliman, ortodoks dhe bektashinj.

Mbi 70 për qind e popullit të Shkodrës ka qënë i persekutuar, i deklaruar, ose siç e quante Partia, "Armik i Partisë së Punës".

HEJ, PASH DREQIN...

pasi në Zot nuk beson se u pushkatuan kaq shumë priftërinj e hoxhallarë, don ti thotë një grua që lutet të mos ia përmend

emrin, Gramoz Ruçit, njërit ndër ish Sekretarët e Parë të Partisë së Punës, a është kështu apo jo?!

E megjithëkëtë, sytë e Shkodrës sot nuk janë të mbushur me mllef, me urrejtje. Njerëzit e kanë lënë pas të shkuarën, paçka se kur ndonjë pjellë ish Sekretari të Parë të Partisë së Punës u kërkon votë, besim, dashuri, u ngjethet mishi, u gufon shpirti, u kujtohet diktatura, mungesa e bukës dhe qyteti që i hante, i përpinte në varr nëse Partia a spiuni thoshte se filani nuk është skllav i ideologjisë së majtë.

Sot njerëzit janë ndryshe, ekonomia ndryshe, liria ndryshe, qyteti ndryshe.

Sot Shkodra është një parajsë. Njerëzit dhe ambienti kanë lidhje harmonike. Ngjyra gri në të bardhë që dominon sot në Shetitoren Kryesore të Shkodrës dhe do shtrihet gjithandej siç thotë nënkryetari i Bashkisë Ritvan Trashani, është ngjyrë pastertie, paqeje, ngjyrë velloje nuseje, saqë kur e shikon me sytë e mëndjes, ndoshta edhe duke kërkuar diku aty ndonjë kujtim të fshehur të rinisë, mëndon:

-Aty tek Katër Yjeshi i Valter

Fushës ishte byrektorja ku...

DIKUR QERASJE ME NJË BYREK

- Tek Rektorari i Universitetit "Luigj Gurakuqi" ishte Komiteti i Partisë së Punës, ku rrinin hijerëndë në Olimp burrokratët që prisnin koka njerëzish me një fjalë goje e hanin djersën e popullit deri në fund të kurritit.

- Tek ky gjimnazi këtu ishte burgu Politik i Shkodrës, ku u pushkatuan qindra heronj të lirisë e demokracisë, ndër ta edhe Prekë Cali që njihet si personi që insistoi në vëndosjen e kufirit mes Shqipërisë e ish Jugosllavisë dhe arriti që zonën e Kelmendit ta lërë tokë shqiptare.

Tek...

- Po këto ndërtime a prishën gjë?, - thua ti që nuk ke qënë kurrë në Shkodër.

Unë të them, dhe hajde shiko e shijo, lulishtet janë ngado, edhe përmes ndarjes së rrugëve, pemët, blirët gati njëshekullor që në pranverë shpërndajnë aromë lulësh, janë këtu, aty ku ishin U bëhet shërbim vazhdimisht, njëlloj si tërë lulishteve në Shkodër. Sheshi mes Kishes së Fretërve, Xhamisë Ebu Bakër dhe Hotel Rozafës është disa herë në muaj skenë arti, ku qyteti mbushet plot njerëz që ndjekin të gëzuar

këngë, valle, humor, instrumentistë.

Shumë piktorë punojnë aty mbrëmjeve të qeta mbi telajo, shumë të rinjë ...

GJUAJNË ME "GURALEC"...

me një zile të lehtë telefoni njëri-tjetrit, duke shkruar kështu njohjet e para në këtë sokak që ngjan edhe me këngë dashurie, edhe me ujvarë, edhe me dritë, edhe me siguri shpirti.

Në panairët e shpeshta sheh punimet e artizanëve shkodranë, shpirtin e tyre krijues. Është ky një profesion i trashëguar prej mijëra vitesh, njëlloj si mikpritja, besa, burrëria, saqë ti mund të thuash me bindje se në Shkodër është investuar këto pesë vite mbi tradita e bukuri, por edhe tradita e bukuria ka "konakun" e vet këtu. Qyteti ka tashmë një funksion tregtar e strukturë të veçantë për zhvillimin e një karakteristike funksionale në shërbim të njeriut, të jetës së njeriut, në shërbim të natyrës, të jetës së natyrës dhe është shëndërruar në një qendër të rëndësishme industriale.

Shkodra është e bukur, e pastër, e freskët, e lashtë dhe e re, si Rozafa që edhe sot pas 2400 vitesh në Kala, pikon "qumësht" nga gjiri...

Piloti që lëshoi bombën mbi Hiroshimë ishte krenar për veprën deri sa vdiq



Ka vdekur në moshën 92 vjeçare në shtëpinë e vet në Columbus të shtetit Ohajo Paul Tibbets. Ishte 6 gushti 1945 kur avioni që hodhi të parën bombë atomike mbi Hiroshima të Japonisë, nisi bombardimin që do regjistronte mbi 140 000 të vdekur. Në komandë të avionit shkatërues ishte Paul Tibbets.

Ishte Paul Tibbets që planifikoi misionin katastrofik, duke u vu në komandën e bombarduesit B 29, të cilin e pagëzoi me emrin e nanës së vet Enola Gay. E para "tornato" nukleare në histori për të fshirë Hiroshimën me qëllim të bindë Japoninë të ndalë luftën. Siç edhe ngjau.

Sa ishte i gjallë asnjëherë nuk u pendua, përkundrazi. Me krenari ka deklaruar se për këtë motiv nuk ka qëndruar qoftë edhe një natë pa gjumë dhe as e ka njohur ndjenjën e fajit. E vetmja e keqe ka shpjeguar është se emri i të ëmës shoqërohet në një vepër luftarake të kësaj natyre.

Tibbets ishte i biri i një grosisti

ëmbëlsirash. Ka qënë i bindur që fëmijë të bëhej pilot e në epokën e fakteve kolonel i forcave ajrore për afro 30 vjet. 140 000 viktima rëndonin mbi ndërgjegjen e tij të çastit, shto pastaj masakren që vazhdoi. Çdo vit kanë vdekur rreth 5000 vetë si pasojë e mbetjeve nukleare. E megjithatë, Paul Tibbets ka deklaruar:

"Ishte luftë dhe në luftë nuk ka moral.

Kanë qënë mijëra pilotë të gatshëm. Gjeneralët e Aeronatikës do zgjidhnin vetëm një për këtë mision delikat. Kishte kaluar pak ora 8 e mëngjesit të 6 gushtit 1945, kur mbërrin autorizimi i presidentit Harry Truman. Ishte Tibbets më i besuari. Mbas 6 orë fluturimi nga ishulli Tnian, bombarduesi ngjyrë argjendi vazhdonte fluturimin mbi Hiroshimë. Në Japoni ora shënon 8 e 16 minuta kur Tibbets shtyp butonin duke hapur barkun e Enola Gay për të hedhur bombën me peshë 4.2 ton, e cila në takim me tokën çliroi temperaturën prej 4000 gradë.

-Nëse Dante Alighieri do kishte qënë në avion me mua, do kishte mbetur i frikësuar duke parë ferrin me sy, -do deklaronte më vonë piloti shkatërrues.

Pak minuta më parë qyteti i kthjellët nga drita e diellit, u kthye në një grumbull të përbindshëm tymi e zjarri. E vështirë ta besojë atë që shihje, por detyra ishte të hedhë bombën e të largohem. Nuk doja të rrija të vështroja si një turist. Shpejtova drejt jugut për t'iu shmangur efekteve të eksplozionit. Ekuipazhi shkrepri disa foto. Njëri shok imi

shkruante në ditar: Zoti im. Objektiv i ishte centruar persosmërisht dhe Enola Gay hyri triumfalisht në bazë duke lënë prapa një rrënoqethje. Kur kreu detyren koloneli Tibbets ktheu në Amerikë duke marrë nderime, por iu desh të ballafaqohet me dy kundërshtarë. Gruaja, pas 17 vitesh martese e braktisi dhe pacifistët filluan ta sulmonin me përbuzje duke e titulluar "Fatura e Vdekjes".

Kjo fyerje është jashtë norme, përsëriste piloti, i cili për aktin e kryer ishte dekoruar.

Po të mos kisha hedhë atomin, SHBA do kishte sulmuar Japoninë dhe numri i viktimave do ishte më i larti, si në ushtri ashtu edhe tek civilët. Njëlloj, kështu mëndonin shumë amerikanë, duke përfshi edhe forcat ushtarake. Tibbets ishte një hero, një pilot shumë iu aftë.

Pas ngjarjes Tibbets nuk shkoi kurrë në Hiroshimë, por ka vizituar Nasakin, ku një koleg i tij 3 ditë pas 6 gushtit kish hedhur dhe ai një bombë të tmerrshme atomike duke shkaktuar 50 000 të vdekur të tjerë.

Në testament ka lënë pak fjalë piloti i vdekjes:

"Dua të evitohen manifestimet e spekulimet. Nuk dua që varri të bëhet vënd protestash nga pacifistët. Kisha me dashtë që historia të më konsideronte më në fund si një patriot, një njeri të aftë për të kryer detyrën dhe që i ka shërbyer atdheut të tij me të gjitha mundësitë.

Aleksander Gargjola



NAPOLEONI I KËNGËS ITALIANE

(pak rreshta për këngëtarin e shquar italian LUCIO DALLA

Ai nuk e kishte bërë asnjëherë thënie të tijën, por miqtë e tij ja kujtonin shpesh atë që thoshte Napoleoni: "Nuk është nevoja të jesh shtatartë për të qenë i madh". Ashtu si Napoleoni, Lucio Dalla ishte shtatshkurtër, madje shumë më i shkurtër se ai. Por, nëse Napoleoni u bë perandori që njihet nga historia, Lucio Dalla u bë në vite Napoleoni i këngës italiane. Perandor në perandorinë e muzikës. E si perandor e përcolli këto ditë për në banesën e fundit, qyteti i tij, Bolonja dhe e tërë Italia. Një dashuri që rrallë figura kanë fatin ta gëzojnë në popull.

Atë ditë kur arkivoli me trupin e këngëtarit të shquar u suall nga Zvicrra dhe u ndal në Piazza Grande në qendër të Bolonjës, sheshi ishte plot me njerëz, që e prisnin. E në atë moment, në shesh gjëmoi kënga e tij e famshme "Piazza Grande", e kënduar nga publiku dhe e transmetuar njëkohësisht nga të gjitha radiot nacionale e lokale në tërë territorin italian. Një homazh në unison i një populli të tërë për këngëtarin e vet.

Piazza Grande...Ishim fare të rinj, studentë, kur e dëgjua për herë të parë atë këngë të Lucio Dallës. Për ne ajo ishte një këngë që i kushtohej një sheshi në Itali. Për Lucio Dallën ai shesh i Bolonjës ishte domethënia e jetës së tij. Skena e tij e parë dhe e fundit. Dashuria e tij e pamatë. Ishte 13 vjeç, kur e ëma i dhuroi një klarinetë, instrumenti i tij i ëndërruar. Nisi t'i binte klarinetës bashkë me instrumentistë të tjerë të rrugës pikërisht në atë shesh. Në Piazza Grande e në lokalet përreth, ai dhe miqtë e tij të pasionuar pas muzikës jazz, luanin gratis për kalimtarët e për klientët e lokaleve, ndonjëri prej të cilëve u ofronte nganjëherë një pjatë karakteristike të kohës me makarona e fasule sa për të mbushur barkun. Ishte në atë shesh tek luante me klarinetë kur tërhoqi vëmendjen e një jazzisti më të njohur, që kishte një bandë të tijën në këtë lloj muzike, Pupi Avati (që më vonë u bë regjisor i njohur filmash). Pupi e ftoi të bëhej pjesëtar i bandës së tij.-Unë mendoja se isha i mirë në klarinetë,-thotë Pupi.-Por aty pashë se ishte dikush tjetër që ishte përtej magjisë në atë instrument...Pastaj, përsëri Piazza Grande dhe lokalet rreth saj. Kishte ardhur një natë në Bolonjë këngëtarin i njohur Gino Paoli. Kujton sërish Pupi Avati: "Atë mbrëmje po u binim instrumenteve gratis në lokal "Whisky a gogò", kur hyri Gino Paoli. Për ta nderuar i dedikuam një pjesë. Kurse Lucio, pa na thënë gjë neve, këndoi për të një balladë... Mbetëm keq kur pamë se Gino Paoli nuk e duartrokite performancën tonë. Por pas pak dërgoi drejt nesh një kamerier. Ai erdhi dhe ju drejtua Lucios:-Mjeshtri do që të flasë. Lucio shkoi ngadalë tek tavolina e tij. Biseduan. Ajo bisedë përcaktoi përfundimisht rrugën e jetës së Lucios, atë të këngëtarit. Atë natë ai u shkëput nga banda jonë, për t'u ngjitur skenave, për t'u bërë këngëtarin i famshëm Lucio Dalla".

Skena...Vetëm një vit më vonë, ishte viti 1971, në skenën e Sanremos do paraqitej një këngëtar me mjekër të dendur, me gjithë moshën e tij të re. Kënga "4 mars 1943" përmbante në titull ditën e lindjes së tij. Ishte Lucio Dalla. Interpreti në mënyrë originale një këngë me tekst e muzikë të tij, që u rendit në vend të tretë, por që ngjalli edhe

lonte talentin e tyre. Kështu njohu, përgatiti e i dha skenës e muzikës italiane shumë e shumë këngëtarë të tjerë. Edhe në festivalin e sivjetëm të Sanremos Lucio u paraqit si drejtues i një grupi orkestral në shoqërimin e një këngëtarin të ri që e ngjiti vetë deri në atë skenë. Ai e donte Bolonjën me një dashuri të pakufishme e të pakondicionuar. Provoi

për Krishtlindje, Lucio na merrte neve si grup dhe na ofronte drekën e festës tek restoranti "Napoleone". E bënte natyrshëm, ulej me ne në tavolinë, bisedonte si të ishte njëri nga ne, hante po atë që hanim ne. Ishte shumë bujar. Kolegët e tij tregojnë se kur dilnin në turne, nuk i lejonte të paguanin qoftë edhe një kafe. Ofronte gjithnjë ai.

- Jam shqiptar,- i thashë.
- Jeni popull inteligjent,-tha ai, duke më rrahur lehtë supin dhe u largua.

Pas asaj dite më qëlloi ta shikoja shpesh në ndeshjet e futbollit të Bolonjës, por edhe në ndeshjet e basketbollit të klubit "Virtus". Sapo më shihte, që nga larg më përshëndeste duke buzëqeshur: Ciao albanese! Ai ishte jo vetëm tifoz, por i ndihmonte edhe ekonomiki-sht këto klube. I pëlqente të loste basketboll, ku gjithmonë ironizonte shtatshkurtësinë e tij. Njëherë u fut të luante edhe me sportistët e « Virtusit », të cilët ishin të gjithë mbi 2 metra të lartë. Ai nuk ishte i lartë as sa këmba e tyre, bënte finta sikur do të markonte më të lartin prej tyre e publiku e duartrokiste me simpati. E pashë për herë të fundit të këndonte dal vivo në një koncert që u organizua pak kohë më parë, me rastin e vizitës së Presidentit Italian Napolitano në Bolonjë. Aty ai interpretoi një variant jazz të këngës "Caruso" e meriti duartrokitjet e stuhishme të publikut e të presidentit.

Kënga "Caruso". Nga më të dashurat e më të famshmet e repertorit të tij. Atë ditë, në momentin që arkivoli me trupin e tij u vendos në katedralen ku do të bëhej mesha e përmortshme, në të gjithë qytetin e në periferi të tij, buçiti në mënyrë të njëkohshme kjo këngë, me zërin e pavdekshëm të Lucios. Edhe në qytetin Cento, ku po zhvillohej festa e carnevaleve (nga më të mëdhatë e më të bukurat në Itali), në atë moment festa u ndal dhe Miss Italia që mjerrete pjesë, intonoi këngën "Caruso". Mijëra e mijëra vetë që merrnin pjesë e kënduan në kor, duke e shoqëruar me duartrokitje deri në fund. Kështu ndodh kur artistët dinjë të gjejnë rrugën për në zemrën e njerëzve.

Muzika e tij e shoqëroi non stop në të 4 ditët para funeralit. Edhe gjatë shetitjes së fundit, nga kodrat e qytetit për në varrezë. Këtë shetitje e kishte dëshiruar ai vetë. Kur në vitin 1976 vdiq nëna e tij e dashur, Jole, ai e përcolli për në varreza duke bërë shetitjen nga kodrat e atë ditë të largët pat thënë: Kur të vijë radha ime, nëpër këtë rrugë dua të më çojnë në varreza e të më vendosin pranë prindërve. E në fakt ashtu u bë. Në momentin e zbritjes së arkivolit në varr, u intonua kënga e tij: „Caro amico, ti scriverò“ (Mik i dashur, po të shkruaj) që u këndua nga rreth dhjetë mijë persona që e përcillnin për në banesën e fundit. Kënga ishte jeta e tij, dhurata e tij për njerëzimin e kënga e shoqëroi edhe në momentet e fundit. Këtë radhë e përzier edhe me lotët e dhimbjes... Vdiq atë ditë që kishte ditën e emrit. U varros më 4 mars, në ditën që mbushte 69 vjet. Për latinët varrosja në ditën e lindjes, është rilindje.

Ndue Lazri



diskutime për kohën. Pas kësaj, kompozitori, poeti e këngëtarin do shkriheshin në një. Lucio Dalla i ka dhënë shumë poezi muzikës së lehtë italiane. Tekstet e tij gjithnjë kanë qenë poezi të mirëfillta. Kujtoni këngën "Caruso". Kishte zbritur në bregdetin magjik të Sorrentos dhe ndodhej përpara hotelit ku dikur shkonte të flinte shpesh këngëtarin i madh lirik Enrico Caruso. Atë pasdite ai soditi për disa orë atë det aq tërheqës, të lëmuar e delikat, si loti i një vajze. Pastaj, befasi u paraqit tek sportellisti i hotelit.-Sa kush-ton dhoma ku flinte C aruso?-i tha. Sportellisti ja tha çmimin.-Po e marr për sonte, megjithëse më duhet vetëm për dy orë,-tha Lucio, që mori çelësat e u ngjiti lart. Filluan të dëgjohehin tingujt e pianos. Në dy orë lindi ajo këngë që shumë shpejt u bë nga më të njohurat e u interpretua në të gjitha skenat e globit e nga këngëtarët më të mëdhenj.

Lucio u bë i famshëm, por mbeti njeriu i thjeshtë, biri i Bolonjës, i lidhur pazgjydhshëmrisht me qytetin e tij, me sheshin e tij. Dritaret e shtëpisë së tij bien pikërisht mbi Piazza Grande. Prej tyre ai shikonte muzikantët e rrugës, që i kujtonin veten e tij dikur. Zbriste, i ftonte në studion e tij, bashkohej me ta e i binte klarinetës, i dëgjonte, zbu-

njëherë të transferohej në Romë. Nuk duroi më shumë se tre vjet larg qytetit të tij. Dhe u kthye sërish përfundimisht tek shtëpia mbi Piazza Grande. Por edhe Bolonja e donte dhe e çmonte floririn e saj të vogël.

Atë mëngjes që erdhi lajmi i vdekjes së Lucios gjatë turneut në Zvicër, muzikantët e rrugës të Piazza Grande u mblodhën poshtë shtëpisë së tij. Shpresonin të mos ishte e vërtetë. Edhe më 12 dhjetor 2010 nga Wikipedia dikush bëri një shaka me shije të keqe, duke dhënë lajmin e rremë që Lucio Dalla kishte vdekur gjatë një turneu në Palermo. Miqtë e tij presin me shpresë që edhe këtë radhë lajmi të ishte i rremë. Por nuk ndodhi ashtu. Sapo lajmi konfirmohet, nga dritaret e pallatit përballë shtëpisë së Lucios, një grup studentësh instrumentistë fillojnë të luajnë e të këndojnë këngë të cantautorit të dashur. Pastaj filluan edhe artistët e rrugës, lokalet, shtëpitë. Ngado këngët e Lucio Dallës mbushnin qytetin. Kështu për 4 ditë, deri në ditën e përcjelljes. Dukej sikur Bolonja nuk ishte në zi, por në festë, ku protagonistin ishte biri i pavdekshëm i qytetit. Aty pranë grupit të artistëve të rrugës vijnë edhe disa të pastrehë. Të mbështjellë nga dhimbja për mikun e tyre. Njëri kujton: Çdo vit

CIAO, ALBANESE!

Atë ditë, për agjencinë ku punoj, do të shpërndaja një material në stadiumin e Bolonjës. Isha tek hyrja e tribunës së personaliteteve dhe shikoja të arrinin njerëzit më me sqimë të qytetit, kasta e tij. I jepja secilit materialin e ata ngjiteshin për në vendet e rezervuara me abonime vjetore. Në një moment shikoj të afrohet një njeri shtatpakët e me mjekër. Lucio Dalla, thashë me vete, por nuk isha i bindur, se më dukej tepër i vogël. Por veshja e tij, krejt ndryshe nga ajo e të tjerëve, ajo që ishte një nga cilësitë e veçanta të tij, më konfirmoi që ishte ai. Ishte hera e parë që e shihja nga afër. Pa e kuptuar e kisha ndalur punën e po e vështroja, ndërsa ai po afrohej gjithnjë e më shumë. Ai u ndal fare pranë, më vështrroi dhe, sikur ta kishte kuptuar hutimin tim, më tha: "Beh, non dà anche a me il suo materiale? (Nuk do më japësh edhe mua materialin tënd?). U skuqa. I zgjata materialin duke i thënë që ishte nder për mua që takoja kaq afër një nga idhujt e muzikës.

- Nga je ti?- më pyeti buzagaz e me ata sytë e vegjël e të ndritshëm, pasi kishte kapur theksin tim të huaj në të folur.

KELMËNDI NË 100 VJETORIN E PAVARËSISË

Mes simpoziumit shkencor shkencor “Kelmëndi në Shekuj” e logut tradicional Mis Bjeshka 2012

Nga Ndue Bacaj

Logu i Bjeshkeve 2012 në treven historike të Kelmendit ketë verë kishte një të veçant të madhe. Organizohet në “100 vjetorin e shpalljes së pavaresisë”, pavaresi për të cilën kelmendasit kishin derdhur lumenjë gjaku e dete mundimesh e sakrificash. Kelmendi në keto luftra e perpjekje shumëshekullore kishte zgjuar interesin e vetë Europes së kohës, e cila jo vetëm e vleresonte, por shpesh kishte pasur aleanca e bashkepunime në kuvende e beteja luftarake kundër osmane dhe pushtuesve të tjerë. Pikrisht për të përjetësuar këtë histori të lavdishme shqiptarie, kryetari i komunes Kelmend Ing. Gjeto Dukaj ishte bërë promotori i organizimit e realizimit të simpoziumit shkencorë “Kelmëndi në Shekuj”. Simpoziumi i paralajmruar do të zhvillohej me datën 10 gusht në sallën e hotelit (në Qafë të Predelecit) me pronar zotin Dodë Dragu. Aty u bë akomodimi i mrekullueshem (me ushqim e fjetje) që me datën 09 (gusht), i personalitetëve që do të mbanin kumtesat në këtë simpozium shkencorë të paralajmruar muaj më përpara. Siç ishte planifikuar, me datën 10 gusht në ora 10.00 filloi punimet simpoziumi shkencorë “Kelmëndi në Shekuj”, simpozium që me kumtesat e paraqitura pershkruan një rrugë historike e heroike shumë shekullore të dokumentuar, jo vetëm të Kelmendit e kelmendasve që banojnë ketu, por edhe të atyre kelmendasve që shekujt i kishin detyruar të banojnë në treva tjera etnike Shqiptare, e deri në ato të Europes. Vlen të theksohet se kumtesat e paraqitura treguan se kelmendasit kudo që jetojnë kanë ruajtur e trashiguar vlerat më të mira të Kelmendit e shqiptarisë. Ligjeratat pershkruan në menyre kronologjike historinë e Kelmendit e kelmendasve nga shekulli i XIV e deri në ditën e pavaresisë 1912, e më gjërë. Vlenë të kujtohet se kumtesat ishin; doktorë, profesorë, akademik, studiues e publicist të njohur kombetarisht e nderkombetarisht. Disa nga keta emra janë: Prof.dr. Zymer Neziri – universiteti i Prishtinës, Prof.dr. Musa Ahmeti, Prof.dr. Etleva Lala – universiteti i Budapestit, Akademik Mark Tirta – Tiranë, Prof.dr. Agron Xhagolli – qendra e studimeve Albanologjike Tiranë, Prof.dr. Lush Culaj – instituti Albanologjik Prishtinë, Prof.dr. Hamit Xhaferrri – universiteti Europes juglindore Tetovë e tjerë duke përfshirë edhe autorin e ketyre rrjeshtave.

Kumtesat u ndoqen me shumë vemvendje nga banorë të Komunes Kelmend, por edhe nga ata të ardhur nga Plavë-Gucia e më gjërë. Simpoziumi u pershendet nga perfaqesues të diasporës, kryesisht nga Amerika. Kryetari i komunes Ing. Gjeto Dukaj mbas perfundimit të simpoziumit

dha dy lajme të mira; botimin e ketyre kumtesave në një liber të veçantë dhe vijimin e simpoziumit

“epik” me emrin **Qafa e Predelecit** u demonstrua edhe njëherë se Kelmendi prej shekujsh është protagoni...

“Retrospektivë historike”

MISET QË KONKURUAN NË LOGU NË LOGUN E BJESHKËVE 2012

Luljete Vukaj, Lira Rezaj, Ermira Nilaj, Zojë Vukaj, Suela Dukaj, Fadjone Gjellaj, Marsela Bujaj, Donjete Ahmetaj, Rilinda Gjonbalaj, Arberore Gjonbalaj, Dodona Hysenaj, Lauora Lajçaj.

ÇMIMET

- *Fituese e Miss Bjeshka 2012 u kurorëzua Marsela Bujaj - Tamare*
- *Shoqeruese të Miss Bjeshkes u perzgjodhen: shoqeruesja e parë Donjeta Ahmetaj – Vuthaj dhe shoqeruesja e dytë: Fadjona Gjellaj – Vukel*
- *Eshte interesant të shenohet se në këtë vitë jubilar të Njëqindë vjetorit të pavaresisë së Shqiperisë, në konkursin e bukurisë së Logut të Bjeshkeve marrin pjesë edhe vajza të bukura me origjinë nga Kelmendi që fati i kishte “hellur” të parët e tyre në troje të tjera etnike shqiptare....sot të ndara me kufij politik, por jo kurrë me kufijë shpirtërorë.*

“Kelmendi në Shekuj” edhe në vitin 2013.

Nga Simpoziumi në traditën Logut të Bjeshkeve...

Mëngjesi i nesër, 11 gushti, si-

nist jo vetëm i qendresës e luftrave mbrojtëse të trojeve të veta me identitet European, por është edhe protagoni i evenimenteve argetuese -festive me karakter civilizues dhe aromë të dallueshme Europere. Në keto troje nuk ka

Logu i Qafes së Predelecit ka një histori mbi tre shekullore të dokumentuar, pamvaresisht viteve të nderprerjeve apo deformimeve që kishin sjellur baticat e zbaticat nder mote e shekuj. Fatkeqesisht



photo: Kastriot Faci

domos për ne që nuk zgjohemi në këto bjeshkë, është i magjishëm. Ka ngjyrë ari lindja e bjeshkët puthin Diellin një e nga një. Në këto bjeshkë me krye në Qiell kullotin shumë dhën e dhi, shumë gjedh, e, barinjte e e presin nadjen me bagëti që i nxjerrin për kullosë heret. Sot mijëra vetë turren tek logu, këtu në Qafë të Predelecit, këtij amfiteatri të mrekullueshem natyror, të zbukuruar bukur nga komuna e të kthyer në një skenë arti.

Ka rahën, sipas tradites së mrekullueshme shumëshekullore Logu i Bjeshkeve. Ketu në vendin

“kënduar” vetëm pushka e hellur valle jatagani në duar të sokolave e sokoleshave kelmendas që i delnin zot kesaj pjese të Europes, por në keto troje edhe kendohej e hillej valle për bukurinë e hijeshinë e “amazonave e spartakeve” kelmendas. Ketu i kendohej dashurisë, jetes, trimave e trimreshave me trajta të kreshnikeve e heronjeve të vertetë, ketu zhvilloheshin edhe lojra popullore e gara të ndryshme, të cilat shoqeronin jetën e ketyre maleve, bjeshkeve e luginave të mrekullueshme që ju a kishte falur vetë krijuesi fisit shqiptarë të Kel-

një baticë e tillë kishte goditur keto troje edhe në vitin 1945 kur sundimtarët shqiptarë që ishin vetpagezuar si “çlirimtarë”, kishin ndaluar apo deformuar shumë gjëra nga tradita kulturore shqiptare, e veçanarisht ato me arome perendimore. Ky fat i keq goditi për 46 vite edhe LOGUN e “Bjeshkeve” ketu në Qafë të Predelecit, të cilin regjimi u mundua ta zevendesonte me ditë të tjera “festive” (në fakt ditë-zie), me kenge e valle për Partinë (Punes) e dishepujt e saj. Për keto mote të liga Malsoreve e Kelmendasve e më gjere nuk u kishte mbetur asgjë

tjetër veçse të “kendonin” pa zë disa vargje që tregonin mjerimin e shekujve me parë por që tingellonin si aktuale edhe në shekullin e XX.. si:

“ Në male të nalta të Haramisë ,
Njatje rrin Ora e Malsisë,
Rrin tuj keqyrë bjeshket me sy ,
Ç’ka u ka ndodhë malsorve të mi,
Që nuk vijnë në bjeshke me hi ,
Thua u kanë ndodhur shumë gjana të keqija ,
ka shkrep luftë, ka shkel ushtria ...”

